



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:067434

Datë: 29.06.2024

Numri i dokumentit: 05876706

KPPP.nr.723/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Hasan Kryeziu, në çështjen përmbartimore të kreditorit “Agroalbi” SH.P.K., me NUI: 810196502, me seli në rr. “Magjistralja Ferizaj - Prishtinë”, në Glllogoc, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Marigona Gashi, avokate nga Prishtina, kundër debitorit “The North Unicorn”, me NUI: 810112186, me seli në rr. “Zona Industriale”, në Prishtinë, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.203/23 të datës 24.03.2023 të Përmbartuesit Privat Bardh Tasholli me seli në Ferizaj, jashtë seancës, me datë 28.06.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. APROVOHET pjesërisht prapësimi i debitorit “The North Unicorn”, dhe Urdhri Përmbartimor P.nr.203/23 i datës 24.03.2023, i Përmbartuesit Privat Bardh Tasholli për pjesën e detyrimit në shumën prej 656.62 € (gjashtëqind e pesëdhjetë e gjashtë euro e gjashtëdhjetë e dy cent), sipas Faturës Nr. 2022-34 të datës 12.01.2022, SHFUQIZOHET.
- II. REFUZOHET PJESËRISHT si i pabazuar prapësimi i debitorit “The North Unicorn”, dhe MBETET NË FUQI pjesa tjetër e Urdhrit Përmbartimor P.nr.203/23 të datës 24.03.2023, të Përmbartuesit Privat Bardh Tasholli sa i përket shumës prej 662.00 € (gjashtëqind e gjashtëdhjetë e dy euro), sipas Faturës Nr. 2022/1030 të datës 07.12.2022; Faturës Nr. 0048506 të datës 18.12.2022; Faturës Nr. 0034274 të datës 09.11.2022 dhe Faturës Nr. 0034266 të datës 22.11.2022, së bashku me kumatën ligjore sipas normës së interesit vjetor prej 8%.

## A r s y e t i m

Përmbauesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të autorizuarit të kreditorit, ka lëshuar urdhrin përmbaues P.nr.203/23 të datës 24.03.2023, me të cilin ka lejuar përmbauesin, në bazë të dokumentit të besueshëm - Faturës Nr. 2022-34 të datës 12.01.2022; Faturës Nr. 2022/1030 të datës 07.12.2022; Faturës Nr. 0048506 të datës 18.12.2022; Faturës Nr. 0034274 të datës 09.11.2022 dhe Faturës Nr. 0034266 të datës 22.11.2022, duke urdhëruar debitorin që në afat prej 7 ditësh pas pranimit të urdhrin t'i paguaj kreditorit tërësisht shumën prej 1,318.62 €, me kamatëvonesë në lartësi prej 8% vjetore, nga data kur është dashur të paguhej secila faturë, e deri në pagesën definitive, si dhe të gjitha shpenzimet e përmbauesit, nën kërcënimin e përmbauesit të dhunshëm, me bllokimin e të gjitha llogarive të debitorit dhe bartjen e këtyre mjeteve nga llogaria e debitorit në llogarinë e kreditorit, si dhe me regjistrimin, konfiskimin dhe shitjen e sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme të debitorit, derisa të kryhet tërësisht detyrimi i të njëjtit ndaj kreditorit.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, ka kundërshtuar në tërësi urdhrin përmbaues duke theksuar se propozimin për përmbaues e karakterizon parregullsia në përmbajtjen e tij, për faktin se fatura e bashkëngjitura nuk përmbajnë nënshkrimin e personit të autorizuar nga ana e debitorit, si dhe vulën e tij. Më tutje ka shtuar se në të dhënat e Agjencisë së Regjistrimit të Bizneseve në Kosovë (ABRK), agjent i regjistruar është B.K., ashtuqë nënshkrimet në faturat e cekura janë të panjohura për debitorin. Ka deklaruar se ndaj kreditorit ka kryer të gjitha obligimet që e tij që ka pasur dhe atë në shumën prej 5,002.01 €, andaj debitori nuk mund të paguaj fatura për të cilat nuk ka qenë në dijeni. I ka propozuar gjykatës që të aprovet në tërësi prapësimi i debitorit dhe të shfuqizohet urdhri përmbaues.

Kreditori në përgjigjen në prapësim të paraqitur brenda afatit ligjor, përmes përfaqësuesit të autorizuar, ka kundërshtuar në tërësi prapësimin e debitorit, ku ndër të tjerash ka deklaruar se në rastin konkret faturat i plotësojnë të gjitha kushtet e parapara ligjore, ku evidentohet edhe nënshkrimi i debitorit që gjendet në dëshmitë mbi pranimin e mallit për secilën faturë. Në lidhje me pretendimin e debitorit se si person i autorizuar është z. B.K. dhe se faturat është dashur të pranoheshin nga i njëjti person, e njëjta nuk qëndron, pasi që dëshmitë e pranimit të mallit janë të pranuar dhe të vullosura me vulën e debitorit, fakt i cili nuk kontestohet duke e bërë dorëzimin e shkresave në mënyrë të rregullt. Gjykatës i ka propozuar që të refuzohet prapësimi i debitorit,

të vërtetohet urdhri përbarimor, si dhe të obligohet debitori që për përpilimin e përgjigjes në prapësim të paguaj shpenzimet në dyfishin e lejuar sipas TOAK.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes në prapësim të kreditorit, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përbarimore, (tutje LPP), gjeti se prapësimi i debitorit është pjesërisht i pabazuar dhe vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, për shkaqet si në vijim:

Gjykata pas shqyrtimit të shkresave të lëndës gjeti se Urdhri përbarimor P.nr.203/23 i datës 24.03.2023, duhet të anulohet pjesërisht për borxhin e kërkuar nga kreditori sipas Faturës Nr. 2022-34 të datës 12.01.2022, për shkak se urdhri i lejuar nuk i plotëson kushtet ligjore sipas dispozitës së nenit 37 të LPP-së, meqenëse në rastin konkret propozimit për përbarim i është bashkëngjitur vetëm kopja e kësaj fature.

Në këtë drejtim, rezulton se propozimi për përbarim mbi bazën e të cilit është lejuar urdhri, sa i përket Faturës Nr. 2022-34 të datës 12.01.2022, përmban të meta ngase në propozim nuk është bashkëngjitur dokumenti origjinal apo kopja e vërtetuar mbi bazën e të cilës është iniciuar procedura përbarimore, ashtu siç parashihet me dispozitën nga neni 38 paragrafi 1 i LPP-së: i cili përcakton se *“Propozimi për përbarim duhet ta përmbajë kërkesën për përbarim në të cilën do të tregohet dokumenti përbarimor origjinal apo kopje e vërtetuar, apo dokumenti i besueshëm..”*.

Sipas nenit 43, par.4 të LPP-së përcaktohet se: *“...Në lidhje me ankesën që ngrehë kundërshtimin ndaj urdhrin të përbarueshmërisë së nxjerrë nga përbaruesi privat, Gjykata që kryen rishikimin e procedurës së përbarimit rishikon nëse janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e atij urdhri nga përbaruesi privat. Nëse Gjykata përcakton se nuk janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e urdhrin për përbarim nga përbaruesi privat, Gjykata shfuqizon urdhrin me vendim”*

Andaj, duke u bazuar në të lartcekurat gjykata vlerëson se në rastin konkret urdhri mbi lejimin e përbarimit sa i përket Faturës Nr. 2022-34 të datës 12.01.2022, është nxjerrë pa u plotësuar kushtet për lejimin e tij, ngase propozimit për përbarim nuk i është bashkëngjitur origjinali apo kopja e vërtetuar e dokumentit të besueshëm dhe rrjedhimisht propozimi për përbarim përmban të meta në kuptim të nenit 38 paragrafi 1 të LPP-së, të cilat në këtë fazë të

procedurës nuk mund të evitohen nga gjykata, ngase në fazën e mjetit juridik, gjykata kufizohet vetëm në shqyrtimin e përshtatshmërisë së dokumentit mbi bazën e së cilit është lejuar urdhri si dhe ligjshmërinë e urdhrit.

Meqenëse në rastin konkret, sipas vlerësimit të gjykatës nuk janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e urdhrit për përmbardim sa i përket faturës së lartcekur, ndërsa organi përmbardues - përmbarduesi privat, nuk ka vepruar konform nenit 38, paragrafi 2 të LPP-së, me të cilin përcaktohet se *“Në rast se propozimi për përmbardim nga paragrafin 1. i këtij neni nuk përmbard shënimet e kërkuara dhe numrin personal identifikues apo numrin e regjistrimit të biznesit të debitorit, organi përmbardues do të veprojë sipas dispozitave të nenit 102 të Ligjit të Procedurës Kontestimore”*, gjykata vendosi si në pikën I të këtij aktvendimi.

Gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit, duke lënë në fuqi pjesën tjetër të urdhrit P.nr.203/23 të datës 24.03.2023 për shumën në vlerë prej 662.00 €, për faktin se fatura në bazë të së cilave është lejuar urdhri për përmbardim, i plotëson kushtet për të qenë dokument i besueshëm dhe i përmbard të gjitha elementet e kërkuara, në përputhje me nenin 29 dhe 37 të LPP-së.

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbardimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, me paragrafin 3 të po të njëjtit nen, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbardim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar “*, ndërsa me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbardim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*, dhe sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të LPP-së fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm, sipas të cilit mund të caktohet përmbardimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Në rastin konkret gjykata vlerëson se urdhri i lejuar nga ana e përmbarduesit privat bazohet në dokumentin e besueshëm - përkatësisht Faturën Nr. 2022/1030 të datës 07.12.2022; Faturën Nr. 0048506 të datës 18.12.2022; Faturën Nr. 0034274 të datës 09.11.2022 dhe Faturën Nr. 0034266 të datës 22.11.2022, të cilat i përmbajnë të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm sipas nenit 29 par. 3 të LPP-së, meqenëse në këto fatura, janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara shërbimet të cilat kanë qenë objekt i këtyre faturave, është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit si dhe koha e përmbushjes së detyrimit dhe të njëjtat janë pranuar nga debitori në mënyrë të rregullt.

Gjykata vlerësoi pretendimin e debitorit, se në rastin konkret ka paguar disa detyrime sipas faturave kontestuese, mirëpo gjeti se një pretendim i tillë është i pa bazuar, për faktin se debitori nuk ka dorëzuar asnjë dëshmi përmes së cilës do të mund të vërtetohej një fakt i tillë, meqenëse nga fletëpagesat e dorëzuara, nuk rezulton se borxhi i paguar ka të bëjë me faturat kontestuese për të cilat është iniciuar propozimi për përmbarim.

Gjykata i vlerësoi edhe pretendimet tjera të debitorit si dhe kreditorit, mirëpo gjeti se të njëjtat nuk mund të jenë objekt shqyrtimi i procedurës përmbarimore prandaj dhe nuk mund të vlerësohen në këtë procedurë, ngase kjo procedurë i nënshtrohet parimit të formalitetit rigoroz, në bazë të cilit nuk lejohet vlerësimi i rrethanave tjera, përpos vlerësimit të elementeve formale të dokumentit në bazë të cilit është lejuar përmbarimi, si dhe përshtatshmërisë së vendimit si objekt përmbarimi.

Gjykata vendosi që të mbetet në fuqi urdhri i përmbaruesit privat edhe në pjesën lidhur me kamatën prej 8%, dhe atë duke u bazuar në nenin 382 të LMD-së me të cilin përcaktohet se: *“Debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton, përpos borxhit kryesor, edhe kamatën”*, dhe vendosi si në pikën II të dispozitivit duke lënë në fuqi urdhrin përmbarimor edhe sa i përket kësaj pjese, për faktin se debitori ka rënë në vonesë për përmbushjen e detyrimit në shumën prej 662.00 €, me çka rezulton se kreditorit i takon e drejta për kamatëvonesë lidhur me këtë shumë që nga momenti kur faturat janë bërë të arritshme për pagesë e deri në pagesën definitive.

Nga sa u tha më lart, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, duke u bazuar në nenin 43, 71 dhe 73 të LPP-së, si dhe nenin 13 par.1 nën par. 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale.

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.723/23, datë 28.06.2024.

Gjyqtari  
Hasan Kryeziu

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.